

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar në Grupin Aricoma a.s. (Aricoma Group a.s.), me seli në Vinohradaska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10 Republika Çeke (Vinohradaska 1511/230, 100 00 Prague 10, Czech Republic),përmes personit të autorizuar Tatjana Popovski Buloski, avokatenga Shoqëria e Avokatëve Popovski dhe Partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 15.11.2022, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të plotë nga Grupi Aricoma a.s. (Aricoma Group a.s.), me seli në Vinohradaska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10 Republika Çeke (Vinohradaska 1511/230, 100 00 Prague 10, Czech Republic),do të fitoj kontroll të plotë mbi Sabris shared services s.r.o. (Sabris Shared Services s.r.o.), me seli në Pekarzhka 621/7, Jinonice, 155 00 Pragë 5, Republika Çeke (Pekařská 621/7, Jinonice, 155 00 Praha 5, Czech Republic), dhe me biznese të caktuara TI - biznes SAP të Sabris CZ s.r.o. me seli në Pekarzhka 621/7, Jinonice, 155 00 Pragë 5, Republika Çeke (Pekařská 621/7, Jinonice, 155 00 Praha 5, Czech Republic), edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifaror 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 14.10.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) është dorëzuar një njoftim për përqendrim nga Grupi Aricoma a.s. (Aricoma Group a.s.), me seli në Vinohradaska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10 Republika Çeke (Vinohradaska 1511/230, 100 00 Prague 10, Czech Republic), me të cilën Grupi Aricoma a.s. do të fitojë kontroll të plotë mbi Sabris shared services s.r.o. (Sabris Shared Services s.r.o.), me seli në Pekarzhka 621/7, Jinonice, 155 00 Pragë 5, Republika Çeke (Pekařská 621/7, Jinonice, 155 00 Praha 5, Czech Republic), dhe me biznese të caktuara TI - biznes SAP

të Sabris CZ s.r.o. me seli në Pekarzhka 621/7, Jinonice, 155 00 Pragë 5, Republika Çeke (Pekařská 621/7, Jinonice, 155 00 Praha 5, Czech Republic).

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Grupi Aricoma a.s. është një kompani holding që menaxhon pjesët në kompanitë e saj vartëse - në veçanti Autocont a.s. dhe Cleverlance Group a.s., AEC a.s.. Autocont fokusohet në zbatimin e projekteve të ndërmarrjeve të mëdha dhe klientëve të mëdhenj, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit të Microsoft Dynamics dhe ofron infrastrukturën e TI-së, aplikacione të korporatave, mbështetjen e proceseve të biznesit, kujdesin ndaj klientit dhe sigurinë e TI-së. Cleverlance Group a.s. është aktive përmes filialit të saj Cleverlance Enterprise Solutions e cila operon në fushën e zhvillimit të softuerit sipas porosisë së klientit. AEC a.s. ofron teknologjitë e sigurisë, vlerësimin e sigurisë, shërbimet e mbrojtjes kibernetike dhe shërbimet këshillimore të GDPR/përputhshmërisë. Ato janë kompani që i përkasin Grupit KKCG.

Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë llotaritë dhe lojërat e fatit, naftë dhe gaz, pasuri të paluajtshme, industri dhe teknologji intelegjente Grupi menaxhon më shumë se 30 kompani në 18 vende të botës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, KKCG Group është i pranishëm në tregun e terminaleve të video lotarisë dhe teknologjisë informatike përmes kompanive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizim të lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare - lojërat e fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare - lojërat e fatit dhe basteve;
- Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet prioritar - programim kompjuterik; dhe
- Qendra edukative dhe zhvillimore Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet prioritar - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër.

Sabris shared services s.r.o. merret me ofrimin e shërbimeve që lidhen me zbatimin e shërbimeve SAP për klientët. Nëpërmjet aktivitetit në fjalë, Sabris CZ s.r.o. merret me zbatimin e SAP dhe menaxhimin e përmbajtjes së ndërmarrjes për klientët në industrinë e automobilave, shitjes me pakicë, logjistikës dhe industrisë së procesit.

Pas marrjes së **Sabris shared services s.r.o.** nga Aricoma a.s., **Sabris shared services s.r.o.** do të fitonte një biznes të caktuar të TI-së- biznes SAP nga Sabris CZ s.r.o.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat*

janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски